

**SHEMBULLI THJESHTON ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 39, DATË 05.08.2013  
“PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË REGJISTRAT PUBLIKË”.**

konkretisht, pika 8 që ka të bëjë me përcaktimin specifik të qëllimit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave që përmbajnë regjistrat publikë.

Shembull ilustrues.

Në shumë vende, Regjistrat e Popullsisë janë zhvilluar në mënyrë të tillë që përfshijnë disa ose të gjitha ngjarjet e mbuluara nga regjistrimi civil (të tilla si lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkuroëzimet, birësimet, etj) por, edhe një gamë të gjerë ngjarjesh të tjera, të tilla si ndryshimi i adresës, numrat e telefonit. Këto regjistra janë përdorur zakonisht për të siguruar informacion të besueshëm në lidhje me popullsinë që mund të përdoret për një shumëllojshmëri qëllimesh publike, të tilla si planifikimi, buxhetimi, qëllime tatimore, lëshim të dokumenteve të identifikimit, pranueshmëria në të drejtën për të votuar, identifikimi i votuesve në listën për të votuar, kujdes shëndetësor, sigurimet shoqërore, etj.

- Si përmbajtja ashtu edhe përdorimi i këtyre regjistrave zakonisht rregullohen sipas ligjeve të veçanta. Edhe pse dispozita të veçanta shpesh janë të pranishme në këto ligje , të tilla si “ informacioni që përmban ky regjistër mund të përdoret për çdo detyrë(qëllime) publike” kjo nuk mund të konsiderohet si qëllim specifik. Ligjet/aktet nënligjore duhet gjithashtu, të përmbajnë detaje për të ofruar siguri ligjore në lidhje me të dhënat personale që përmbajnë këto regjistra. Këto dispozita duhet të specifikojnë në çfarë situatash dhe për çfarë qëllimesh të dhënat mund të përdoren dhe kujt kategorie të subjekteve të të dhënave ju drejtohet informacioni. P.sh, në rast se regjistrat e popullsisë bëhen publikë për qëllime të votimeve elektorale duhet të ketë parashikim të qartë ligjor, në lidhje me këtë qëllim, për aksesin dhe kategorinë e subjekteve të të dhënave personale për të cilët është bërë publik informacioni që përmban ky regjistër.

- Një rast tjetër mund të jetë kur regjistrat e popullsisë mund të formojnë bazën për shërbimet e-government. Kjo është e kuptueshme me një tendencë gjithmonë e më shumë në rritje të ofrimit të shërbimeve të tilla(p.sh, le të përmendim vetëm iniciativën One-Stop-Shop). Në rast se ndodh kjo gjë atëherë parashikime dhe rregulla të qarta, specifike dhe proporcionale janë me vend për tu përfshirë në ligj/akt nënligjor përkatës për të qartësuar se si informacioni që gjendet në regjistrat e popullsisë mund të përdoret për këtë qëllim(pra, për shërbimet e-government), për aksesin dhe kategorinë e subjekteve të të dhënave personale për të cilët është bërë publik informacioni që përmban ky regjistër.

Sfida kryesore në përcaktimin e qëllimeve specifike gjithsesi, mbetet që në përcaktime të tilla të gjendet balanca e duhur midis ofrimit të qartësimit ligjor të duhur në lidhje me informacionin që përmbajnë këto regjistra dhe qëllimin e përdorimit, por pa bërë që parashikime të tilla të jenë shumë të ngurta.